



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri



DOKUMENT POLITIKASH

HEQJA E TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR
(TVSH) PËR PRODUKTET E HIGJENËS
MENSTRUALE: NJË HAP DREJT BARAZISË
GJINORE, SHËNDETIT PUBLIK DHE
DREJTËSISË SOCIALE

TIRANË, MARS 2026

DOKUMENT POLITIKASH

HEQJA E TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH) PËR PRODUKTET E HIGJENËS MENSTRUALE: NJË HAP DREJT BARAZISË GJINORE, SHËNDETIT PUBLIK DHE DREJTËSISË SOCIALE.

Ky dokument politikash është përgatitur nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri dhe Agora Sociale në kuadër të projektit “Mbështetje për Parlamentin dhe Shoqërinë Civile” (PACEP II) – një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Global Partners Governance (GPG) Albania.

Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane, Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ose Global Partners Governance Albania.

Përgatitën dokumentin: Adena Vangjeli, MSc
Elsa Zhega, MSc

Autorë: © Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
© Agora Sociale

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektet autorë. Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tyre.

I. PËRMBLEDHJE

Produktet e higjienës menstruale si pecetat, tamponët dhe kupat menstruale nuk janë produkte luksi, por nevoja themelore që garantojnë shëndetin, dinjitetin dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe vajzave në jetë sociale, arsim dhe punë. Aktualisht, këto produkte në Shqipëri taten me normën standarde të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) 20%, duke rritur barrën ekonomike për gratë dhe vajzat, veçanërisht ato në situatë varfërie duke kontribuar në fenomenin e njohur ndërkombëtarisht si “varfëri menstruale”.

Në pjesën më të madhe të vendeve të Bashkimit Europian, produktet menstruale trajtohen si mallra të domosdoshme dhe taksohen me normë të reduktuar (deri në 5%) ose zero TVSH, kjo bazuar edhe në Direktivën 2022/542 të Këshillit të Bashkimit Europian. Në Shqipëri, klasifikimi si produkte higjienike të zakonshme rrit çmimin pa reflektuar rëndësinë e tyre për shëndetin publik.

Heqja e TVSH-së mbi produktet higjienike menstruale dhe klasifikimi i tyre si produkte bazë shëndetësore është një hap i rëndësishëm drejt eliminimit të varfërisë menstruale, promovimit të barazisë gjinore dhe garantimit të shëndetit publik në Shqipëri. Kjo masë është ekonomishtë e arsyeshme, e drejtë nga pikëpamja sociale dhe në përputhje me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian.

Ky dokument politikash rekomandon një reformë fiskale që përfshin përjashtimin nga TVSH-ja të produkteve menstruale dhe klasifikimin e tyre si produkte bazë të kujdesit shëndetësor, si një masë e domosdoshme për garantimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Shqipëri.

II. HYRJE

Gjatë viteve, kostoja e tatimit mbi produktet menstruale ka qenë një temë me debat në rritje në publik. Duke qenë se këto produkte përdoren ekskluzivisht nga gratë, çështja diskutohet për ndikimin e saj ekonomik mbi bazë gjinore. Tatimi vendos një barrë financiare të padrejtë dhe sistematike mbi gratë dhe kontribuon në varfërinë menstruale. Ndryshe nga produktet e tjera të konsumit, këto mallra janë nevojë biologjike dhe jo një zgjedhje.

Në prill të vitit 2022, një rishikim i Direktivës së TVSH-së së BE-së solli më shumë fleksibilitet për Shtetet Anëtare për të ulur normat e TVSH-së mbi produktet higjienike për gratë. Ky ndryshim u lejoi Shteteve Anëtare të ulin normën e TVSH-së deri në 0%, krahasuar me normën minimale të mëparshme prej 5 %. Parlamenti Europian bëri thirrje që Shtetet Anëtare të ulin më tej normën e TVSH-së.

Krahasimi i normave të TVSH-së për produktet e higjienës menstruale në Europë tregon një trend të qartë drejt uljes ose eliminimit të tatimit mbi këto produkte, duke i konsideruar si nevojë bazë dhe jo luks. Shqipëria, duke mbajtur një normë prej 20%, jo vetëm që mbetet larg standardeve të BE-së, por gjithashtu thëllon pabarazinë gjinore dhe barrën ekonomike mbi gratë dhe vajzat. Kjo situatë ka ndikime të drejtpërdrejta në pjesëmarrjen sociale, arsimore dhe ekonomike të grave, duke penguar jo vetëm mirëqenien e tyre personale, por edhe zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Nga sa më sipër, heqja e TVSH-së mbi produktet e higjienës menstruale nuk është vetëm një masë fiskale, por një politikë publike që adreson drejtësinë sociale, barazinë gjinore dhe shëndetin publik. Një reformë fiskale e tillë do të ishte në linjë me detyrimet e Shqipërisë si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe me rekomandimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e higjienës menstruale. Ajo siguron që çdo grua dhe vajzë të ketë akses të barabartë dhe të përballeshëm në produkte themelore për shëndetin dhe dinjitetin e saj, duke kontribuar kështu në uljen e varfërisë menstruale dhe promovimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

III. QASJA DHE REZULTATET

Aksesi në produkte higjienike menstruale është një komponent i rëndësishëm i shëndetit publik, mirëqenies dhe dinjitetit të grave dhe vajzave. Menstruacioni është një proces biologjik natyror që prek gjysmën e popullsisë së botës për një periudhë të jetës së tyre rreth 40 vite, duke përlogaritur se mesatarisht menstruacionet fillojnë në moshën 12 vjeçare dhe përfundojnë 52 vjeç. E drejta për higjienë menstruale është një e drejtë e lidhur drejtpërdrejtë me të drejtat themelore të njeriut sanksionuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, si:

- nenet 1 dhe 2 “Barazia dhe mosdiskriminimi” sanksionojnë se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta. Taksa mbi produktet menstruale ose mungesa e aksesit në to mund të krijojnë diskriminim gjinor;
- neni 25 “E drejta për një standard të përshtatshëm jetese dhe shëndet” përfshin kujdesin shëndetësor dhe mirëqenien. Kjo është baza kryesore që mbështet se produktet menstruale janë nevojë bazë shëndetësore;
- neni 26 “E drejta për arsimim”. Varfëria menstruale mund të çojë në mungesë në shkollë për vajzat.

Nisur nga sa më sipër, e drejta për higjienë menstruale duhet të trajtohet si pjesë e të drejtave të njeriut. Nevoja për konsum të produkteve të higjienës menstruale është nevojë fiziologjike, jo luks.

Studime të organizatave ndërkombëtare tregojnë se pamundësia për të siguruar produkte menstruale mund të çojë në përdorimin e alternativave të pasigurta dhe në rritjen e rrezikut të infeksioneve dhe problemeve të tjera shëndetësore për gratë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe UNICEF kanë theksuar rëndësinë e përfshirjes së higjienës menstruale në politikat e shëndetit publik dhe në programet e barazisë gjinore. Sipas një raporti të përbashkët të OBSH dhe UNICEF, rreth 500 milion gra dhe vajza në botë përballen me mungesë të produkteve menstruale ose të kushteve të përshtatshme për menaxhimin e higjienës menstruale[1].

Shtetet kanë detyrimin pozitiv për të garantuar akses në produkte dhe shërbime të higjienës menstruale, si pjesë e detyrimeve të tyre në fushën e shëndetit publik dhe të drejtave të njeriut.

Një rezolutë historike mbi Menaxhimin e Higjienës Menstruale (MHM), të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore u miratua në sesionin e 56-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në Gjenevë nga 18 qershor deri më 12 korrik 2024. Ajo thekson rolin thelbësor të MHM në avancimin e së drejtave të njeriut për shëndet dhe barazi gjinore.

Në mënyrë specifike, ajo bën thirrje për:

- Akses universal: sigurimin që gratë dhe vajzat, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, të kenë akses në produkte dhe ambiente të përbalueshme, të sigurt dhe të pastra për higjienën menstruale;
- Përmirësim të infrastrukturës: ofrimin e aksesit në ujë dhe kushte të përshtatshme sanitare në hapësira publike dhe private, përfshirë shkollat, për të mbështetur menaxhimin e sigurt të higjienës menstruale;
- Përbalueshmëri dhe mbështetje ekonomike: eliminimin ose uljen e të gjitha taksave mbi produktet menstruale dhe mbështetjen e personave në situatë vulnerabiliteti ekonomik me alternativa falas ose të përbalueshme; dhe
- Rritje të ndërgjegjësimit dhe edukimit: integrimin e MHM në politikat kombëtare përkatëse, përfshirë programet e ujit, sanitacionit dhe higjienës, si dhe promovimin e aksesit të grave dhe vajzave në informacion dhe edukim të përshtatshëm dhe të aksesueshëm mbi MHM.

[1] UNICEF & World Health Organization (2021). State of the world's sanitation and menstrual health.

Në 5 Prill 2022, Këshilli i Bashkimit Europian, miratoi Direktivën 2022/542 e cila amendoi direktivat 2006/112/EC dhe (EU) 2020/285 lidhur me normën e TVSH. Në këtë direktivë theksohet shprehimisht se *“Shtetet Anëtare lejohen të aplikojnë një normë të reduktuar më të ulët se minimumi prej 5 % për mallrat dhe shërbimet që konsiderohen se mbulojnë nevojat bazë, përkatësisht ato që lidhen me furnizimin me ushqime, ujë, barna, produkte farmaceutike, produkte shëndetësore dhe higjienike, transportin e personave dhe disa artikuj kulturorë (libra, gazeta dhe periodikë)”*.

Po kjo direktivë, amendon edhe Aneksin III të Direktivës 2006/112/EC për të cilin saktëson se *“tek produktet shëndetësore dhe higjienike, përfshihen produktet e përdorura për kontracëpsion dhe mbrojtjen e higjienës së grave, si dhe produktet higjienike absorbuese”*.

Në këtë kontekst, Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian, duhet të harmonizojë politikën e saj fiskale me këto standarde.

Në Shqipëri, norma standarde e TVSH-së është 20%, dhe kjo aplikohet për shumicën e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë produktet e higjienës menstruale. Kjo do të thotë që **pecetat higjienike, tamponët dhe produktet e tjera menstruale taten njësoj si çdo mall konsumi**.

Në vitin 2024, organizata *“Together for Life”* publikoi raportin *“Mbi të drejtën e higjienës menstruale dhe ndikimit të saj në jetën e grave në Republikën e Shqipërisë”* në të cilin ka përlogaritur barrën ekonomike për gratë që vjen nga kostot e produkteve menstruale, kosto e cila patjetër që nuk ekziston për burrat. Kjo e bën këtë çështje jo vetëm një çështje të shëndetit publik, por edhe një çështje të qartë të pabarazisë gjinore dhe drejtësisë sociale. Barra e diferencuar financiare mbi bazë gjinore përbën një formë të tërthortë diskriminimi, duke vendosur gratë dhe vajzat në një pozitë të pafavorshme ekonomike. Për më tepër, kjo barrë rëndohet edhe nga aplikimi i TVSH-së në nivelin standard, duke e rritur më tej koston e aksesit në produkte që janë thelbësore për dinjitetin dhe mirëqenien e tyre. Në këtë kuadër, politika fiskale aktuale jo vetëm që nuk adreson këtë pabarazi, por kontribuon në thellimin e saj.

Sipas studimit në fjalë, një gruajë me pagë mesatare prej 49000 lekësh i duhet të punojë 3.4 muaj gjatë gjithë jetës së saj riprodhuese për të paguar koston e shëndetit menstrual. Për një vit, një vajzë dhe gruajë i duhet të shpenzojë 2880 lekë për produkte menstruale dhe gjatë gjithë kohës së menstruacioneve (mesatarisht 40 vjet), kjo kosto shkon 115200 lekë për grua/vajzë[2] nga të cilat 20% përbëjnë TVSH.

Shpenzimet për higjienën menstruale janë të paevitueshme dhe jo domosdoshmërisht lidhen me mundësitë financiare të grave për ti përballuar ato. Statistikat e punësimit të grave në Shqipëri tregojnë se 53.8% e vajzave dhe grave të moshës 15-64 vjeç janë të punësuar. Nga gratë e punësuar 18.3% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes, ndërsa 7.6% e tyre janë të papuna dhe 38.6% janë jashtë forcës së punës. Pra, raporti thekson se, rreth 46.2% e grave në Shqipëri nuk kanë një burim të ardhurave nga puna për të financuar shpenzimet e tyre të domosdoshme ku përfshihen edhe shpenzimet për higjienën menstruale. Ekziston një lidhje e drejtë logjike ndërmjet pamundësisë financiare për të përballuar koston e pecetave higjienike dhe medikamenteve menstruale dhe përqindjes së grave që janë ekonomikisht jo aktive. E kombinuar kjo dhe me faktin që pjesa më e madhe e popullsisë në Shqipëri banon në zonat rurale, arrihet në përfundimin se një pjesë e konsiderueshme e grave dhe vajzave janë në vështirësi për të financuar nevojat e tyre minimale të kujdesit personal[3].

Në Shqipëri ka patur një nismë të mëparshme të ngjashme, por e cila ka rezultuar e pasuksesshme. Në nëntor të vitit 2023, u soll për herë të parë për diskutim në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë rishikimi i politikës së taksimit të produkteve të higjienës menstruale, duke përjashtuar TVSH-në nga produktet higjieno-sanitare të vajzave dhe grave. Në atë kohë, kjo nismë u rrëzua nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat me arsyetimin se do të rivlerësohej në një moment të dytë.

[2] https://www.togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2024/05/RAPORT_Mbi-te-drejte-e-higjienes-menstruale-dhe-ndikimit-te-saj-ne-jete-e-grave-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf

[3] Në këto kosto nuk janë përlogaritur ilaçet për dhimbje menstruale.

Në nëntor të vitit 2025, Shqipëria hapi të gjithë grupkapitujt e negociatave për anëtarësim në Bashkimin European, një hap ky i rëndësishëm drejt harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet dhe direktivat e BE-së, përfshirë edhe fushat që lidhen me barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në vazhdimësi të procesit të anëtarësimit, Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin vendas me *acquis* të Bashkimit European. Kjo do të thotë se duhet të shkojë edhe drejt reduktimit ose heqjes së vlerës së TVSH-së për produktet e higjienës menstruale, ashtu siç rekomandon Direktiva 2022/542. Aktualisht, Shqipëria ka normë ndër më të lartat në Europë sa i përket produkteve menstruale.

Norma e TVSH-së për produktet e higjienës menstruale në disa vende të Europës:

Shteti	Norma e TVSH-së
Irlanda	0%
Austria ¹	0%
Malta	0%
Qipro	0%
Luksemburgu	3%
Spanja	4%
Polonia	5%
Franca	5.5%
Belgjika	6%
Portugalia	6%
Gjermania	7%
Hollanda	9%
Italia	10%
Kroacia	13%

[1] Hequr TVSH-ja më 1 Janar 2026.

Ky dokument politikash nuk ka synuar të kryejë një analizë të detajuar fiskale mbi efektet e heqjes së TVSH-së në të ardhurat buxhetore. Megjithatë, duke marrë në konsideratë përvojat ndërkombëtare dhe natyrën e këtyre produkteve si mallra të domosdoshme, vlerësohet se ndikimi fiskal do të ishte i kufizuar dhe i përballueshëm. Për më tepër, eliminimi i TVSH-së pritet të kontribuojë në rritjen e aksesit dhe konsumit të produkteve menstruale, si dhe në uljen e kostove afatgjata shëndetësore, duke krijuar një efekt pozitiv të përgjithshëm për shoqërinë dhe ekonominë.

Në përfundim, rezultatet e analizës tregojnë se heqja e TVSH-së mbi produktet menstruale do të kishte ndikim pozitiv në reduktimin e kostove për konsumatorët, në përmirësimin e aksesit në produkte higjienike dhe në avancimin drejt barazisë gjinore në politikat fiskale dhe sociale.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në Shqipëri produktet menstruale taten me normën standarde të TVSH prej 20%, një nga nivelet më të larta në Europë për këtë kategori produktesh. Kjo do të thotë se produktet higjienike menstruale trajtohen fiskalisht si mallra konsumi të zakonshëm dhe jo si produkte bazë të kujdesit shëndetësor. Studime dhe raporte të organizatave vendase tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e grave dhe vajzave në Shqipëri përballen me vështirësi ekonomike për të përballuar këto produkte, veçanërisht duke pasur parasysh se vetëm 53.8% e grave janë të punësuar dhe një pjesë e madhe e tyre janë jashtë tregut formal të punës. Në vitin 2023 është diskutuar në Kuvend propozimi për përjashtimin nga TVSH të produkteve menstruale, çka tregon se kjo çështje është tashmë pjesë e debatit publik dhe politik në vend por ende nuk janë ndërmarrë hapa konkretë drejt ndryshimit të kuadrit ligjor në këtë drejtim.

Analiza e politikave aktuale fiskale dhe sociale në Shqipëri tregon se ekziston hapësirë për ndërhyrje që mund të përmirësojnë aksesin në produkte menstruale dhe të reduktojnë pabarazitë gjinore në koston e jetesës.

Produktet menstruale janë produkte thelbësore për shëndetin dhe dinjitetin e grave dhe vajzave, dhe trajtimi i tyre si mallra konsumi të zakonshëm nuk reflekton rëndësinë e tyre për shëndetin publik. Në këtë kontekst, një reformë fiskale që redukton ose eliminon TVSH-në mbi këto produkte do të ishte një hap i rëndësishëm drejt politikave më të ndjeshme ndaj barazisë gjinore.

Bazuar në analizën e paraqitur në këtë dokument, rekomandohen këto masa konkrete:

- Përjashtimi nga TVSH-ja i produkteve të higjienës menstruale, përmes ndryshimit të legjisllacionit përkatës fiskal, duke i klasifikuar ato si produkte bazë të kujdesit shëndetësor dhe jo si mallra konsumi të zakonshëm;
- Alternativisht, aplikimi i një norme të reduktuar të TVSH-së (0–5%), në përputhje me fleksibilitetin e parashikuar nga Direktiva 2022/542 e Bashkimit Europian, si një hap i ndërmjetëm drejt eliminimit të plotë të taksës;

- Sigurimi që përjashtimi nga TVSH-ja, ose alternativisht aplikimi i një norme të reduktuar, të reflektohet në uljen reale të çmimit të produkteve të higjienës menstruale për konsumatorët;
- Sigurimi i produkteve menstruale falas në institucionet publike, si shkollat, universitetet, qendrat shëndetësore dhe institucionet e kujdesit social, për të garantuar akses universal dhe për të reduktuar braktisjen shkollore të lidhur me varfërinë menstruale;
- Integrimi i menaxhimit të higjienës menstruale në politikat kombëtare të shëndetit publik dhe arsimit, duke përfshirë edukimin mbi shëndetin menstrual në kurrikulat shkollore dhe fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë;
- Përmirësimi i infrastrukturës sanitare në institucionet publike, veçanërisht në zonat rurale, për të siguruar kushte të përshtatshme për menaxhimin e higjienës menstruale;
- Mbledhja dhe publikimi i të dhënave të disagreguara mbi varfërinë menstruale në Shqipëri, për të mbështetur politikëbërjen e bazuar në evidencë dhe për të monitoruar efektet e ndërhyrjeve të ndërmarra;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me shoqërinë civile, për të garantuar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse në adresimin e kësaj çështjeje.

V. PËRFUNDIME

Heqja e TVSH-së mbi produktet menstruale përfaqëson një reformë të rëndësishme që do të kontribuonte në reduktimin e pabarazive gjinore dhe në përmirësimin e shëndetit publik në Shqipëri. Produktet menstruale janë një nevojë bazë biologjike dhe trajtimi i tyre si mallra luksi ose si produkte konsumi të zakonshëm nuk është në përputhje me realitetin social dhe shëndetësor.

Reformat fiskale në këtë fushë janë ndërmarrë tashmë nga shumë vende europiane dhe janë mbështetur nga organizata ndërkombëtare dhe institucionet e Bashkimit European. Në këtë kontekst, Shqipëria ka mundësinë të ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt politikave më të drejta dhe më gjithëpërfshirëse, politika këto në përputhje edhe me *acquis communautaire* të Bashkimit European.

Heqja e TVSH-së mbi produktet menstruale nuk është vetëm një çështje fiskale, por një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në mbështetje të shëndetit publik, barazisë gjinore dhe mirëqenies sociale. Një reformë e tillë do të kishte ndikim konkret në jetën e përditshme të grave dhe vajzave dhe do të përfaqësonte një hap të qartë drejt një shoqërie më të barabartë dhe më të drejtë. Për këtë arsye, ndërmarrja e kësaj reforme duhet të konsiderohet një prioritet në agjendën fiskale dhe sociale të vendit.

VI. REFERENCA

Parlamenti Europian, Shërbimi i Kërkimit (2023). *Taksa mbi tamponët dhe varfëria menstruale në Europë.*

Sommer, M., Hirsch, J., Nathanson, C., & Parker, R. (2016). *Në mënyrë të rehatshme, të sigurt dhe pa turp: Përcaktimi i menaxhimit të higjienës menstruale.* Revista Amerikane e Shëndetit Publik.

UNICEF & Organizata Botërore e Shëndetësisë (2021). *Gjendja e sanitacionit dhe shëndetit menstrual në botë.*

Organizata Botërore e Shëndetësisë (2022). *Shëndeti dhe higjiena menstruale: Udhëzues për politikën.*

Bashkimi Europian (2022). *Direktiva e Këshillit (BE) 2022/542 për ndryshimin e normave të TVSH-së.*

Together for Life (2024). *Raport mbi të drejtën e higjienës menstruale dhe ndikimin e saj në jetën e grave në Republikën e Shqipërisë.*

https://www.togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2024/05/RAPORT_Mbi-te-drejten-e-higjenes-menstruale-dhe-ndikimit-te-saj-ne-jete-e-grave-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf

Kombet e Bashkuara (2024). *Rezoluta mbi menaxhimin e higjienës menstruale, të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.*